



Mbi kontributin e prof. Aleksandër Xhuvanit në fushën e gjuhësisë

Msc. Julian Fakaj

Abstract

Linguistics is the area in which A. Joe has devoted his entire life to language studies since his youth. Language issues have always been closely related to the language structures as well as to the needs of the school and the national culture. His assistance has been in all areas of Albanian linguistics, such as: lexicology, lexicography, grammar and language history, in the field of word formation and language culture, providing his important contribution to theoretical studies linguistic and practical solutions important for the Albanian literary language, for education and lexicography. His articles, works, monographs and texts are of great scientific value.

Key words: assistance, work, language norms, national culture.

Abstrakt

Gjuhësia është fusha së cilës A. Xhuvani i kushtoi gjithë jetën e tij duke iu futur studimeve gjuhësore që në rininë e tij. Çështjet e gjuhës i ka parë vazhdimisht në lidhje të ngushtë me strukturat gjuhësore si dhe me nevojat e shkollës dhe të kulturës kombëtare. Ndhimesa e tij ka qenë në të gjitha fushat e gjuhësisë shqiptare, si: në leksikologji, e leksikografi, në gramatikë e në histori të gjuhës, në fushën e formimit të fjalëve dhe të kulturës së gjuhës duke dhënë ndihmesën e Tij të rëndësishme në studimet teorike gjuhësore, ashtu edhe në zgjidhjet praktike me rëndësi për gjuhën letrare shqipe, për arsimin dhe për leksikografinë. Artikujt, punimet, monografitë e tekstet e tij janë me vlerë të madhe shkencore.

Fjalë kyçe: ndihmesë, punim, normë gjuhësore, kulturë kombëtare.

Aleksandër Xhuvani (1880-1961), është një nga figurat më të shquara në historinë e shkollës, të shkencës dhe të kulturës sonë kombëtare, edhe në kohë më të vështira, gjithë forcat e veta, morale e fizike, gjithë dijen dhe aftësitë e tij mendore, ia kushtoi çështjes së madhe të përdorimit të gjuhës shqipe, si veçori e dallësës kombëtare, të ecjes së këtij vendi si veçori e një kombi, duke i dhënë prioritet trashëgimisë sociale

kulturore gjuhësore të thesarit të paçmueshëm të kombit shqiptar.

Karakteristikë e punës së tij ka qënë se ka mbetur besnik i mbrojtjes me vendosmëri të gjuhës shqipe kundër çdo lloj shkombëtarizimi të saj; vet deklamonte se *ai që nuk kujdeset e nuk interesohet sot për gjuhën e vet nuk do as kombësinë e vet, pasi gjuha është shenja më e dukshme e saj dhe kur çdo përdorues i saj tregon një mospërfillje të një pakujdesie për gjuhën e vet, kjo krijon fundin e një jete*¹.

Që student nisi të interesohej për gjuhën shqipe dhe të shkruante për të artikujt, që bien në sy për formimin shkencor të tij dhe për kompetencën me të cilën janë shkruar. A. Xhuvani merr pjesë në diskutimet që u hapën në shtypin kombëtar për problemet themelore e të veçanta të gjuhës letrare, duke u dalluar për mendimin e tij të pjekur që jep nga fundi i vitit 1906: *"Dua të them se vjet n'Athinë, i ikun nga Elbasani plot me mendime atdhetare, më hyni një ndezë e një ande e madhe fort për gjuhën tonë. E pra, ndaj në Athinë u dhashë pas punimit të gjuhës shqipe, bana disa mësim të vogla përmbi at, krijova për vete parimet e mendimet e para përmbi disa vepra që kam qëllim t'i botoj me kohë. U bash pajtuer "Albania" e ma në fund nisa të faqësor mendimet e mija atdhetare tek grekët... korrikut, një muej përpara se t'iki nga Athina, mora shkajk një artikull qi u botue ke ditari "Kratos" përmbi shqiptarët, të cilët i bante grekë e i çova ditarit "Kratos" një përgjigje të gjatë, ku i thoja mendimet e mija shqiptare e disa të tjera; artikulli im, nënshkruar me pseudonimin Sul Doka, nuk u botue, sikundër nuk u botue as ndonji artikull i im që çojë sa e sa herë nëpër ditaret e tjera..."*²

Pasi jep provimet e vitit të katërt të Fakultetit të Filologjisë, në gusht të 1906 Aleksandër Xhuvani shkoi prej Athinës në Napoli, ku ka rast të njihet së afërmi me Luigj Gurakuqin, me arbëreshë të ndryshëm e me Ismail Qemalin. Me ndihmën e tyre, zë punë si mësues i gjuhës shqipe në kolegjin arbëresh të Shën Adrianit, ku kishte dhënë mësim për sa e sa vjet poeti e patrioti i madh Jeronim De Rada. Këtu, krahas punës së tij mësimore,

¹ Domi, M., "Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar", Tiranë, 1980, f. XII, prg.2.

² Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, "Aleksandër Xhuvani", Mahir Domi, "Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar", Tiranë, 1980, f. XIII



shkruan në shtypin kombëtar artikuj gjuhësorë, ndonjë artikull politik ndonjë krijim letrar a ndonjë përkthim. Meriton të përmendet studimi "Prejardhja e pjesavet të fjalës në gjuhën shqipe. Substantivat", botuar në disa numra të gazetës "Albania" (1906 e 1907).

Vitet e kaluara në kolegjin e Shën Mitrit i dhanë mundësi studiuës të ri të njihet mirë me letërsinë arbëreshe e visarin gjuhësor të arbërishtes. Prof.A.Xhuvani do të merret më vonë disa herësh me letërsinë arbëreshe e veprat e autorëve arbëreshë me ëndje të veçantë, si një nga njohësit më të mirë të saj.

Kongresi i Elbasanit, që zhvilloi punimet më 2-9 shtator 1909, vendosi hapjen e një shkollë normale në Elbasan për formimin e kuadrit mësimor të nevojshëm dhe caktoi masat për ngritjen dhe mbajtjen e saj. Drejtimi i shkollës iu besua patriotit të shquar, poetit dhe publicistit të njohur, Luigj Gurakuqit.

Si mësues në këtë shkollë u thirr edhe Aleksandër Xhuvani. Më 1 dhjetor 1909, në mes të një entuziazmi të përgjithshëm, hapte dyert kjo shkollë e parë e mesme e arsimit tonë kombëtar . Prof.A.Xhuvani gjatë vitit shkollor 1909-1910 punoi si mësues i shqipes e i ndonjë lënde tjetër, me zell të madh për arsimimin e nxënësve të etur për dije, të ardhur nga vise më të ndryshme të Shqipërisë .

Që në këtë kohë, ai i hyri punës për hartimin e një teksti shkollor të gramatikës shqipe. Mbyllet shkolla Normale, ndiqen patriotët, krijohet një gjendje shumë e rëndë. A. Xhuvani ikën nga Elbasani dhe shkon në Kajro të Egjiptit. Atje ngarkohet si redaktor i gazetës "Shkreptima" që nisi të nxjerrë Fazil Toptani. Pas Shpalljes së Pavarësisë, u kthye në atdhe dhe, me rihapjen e Shkollës Normale të Elbasanit, punoi si drejtor i saj gjatë vitit shkollor 1913-1914 dhe më pas në vitet 1917-1920. Me iniciativën e Luigj Gurakuqit, atëherë Drejtor i Përgjithshëm i Arsimit, u krijua më 1917 Komisia Letrare në Shkodër për përpunimin e terminologjisë, të drejtshkrimit dhe për kodifikimin e njësimin e gjuhës letrare shqipe. Në verën e vitit 1920 është Kryetar i Kongresit Arsimit të Lushnjës, që sugjeroi një sërë masash për organizimin e arsimit tonë kombëtar, për gjuhën e shkollës dhe mori vendime për përcaktimin e terminologjisë shkollore.

Në vitet 1920-1922 A. Xhuvani punoi në Ministrinë e Arsimit, në Këshillin e Epër Arsimit dhe në vitet 1922-1929 si drejtor i shkollës Normale të Elbasanit³ Ndër të parët libra të gjuhës të karakterit metodik

³ -Prof. A. Xhuvani në mënyrë sistematike, me një vull prej të riu, punon në Ministrinë e Arsimit në hartimin e programeve dhe të teksteve të reja ; jep edhe letërsinë e vjetër arbëreshe pranë Institutit Pedagogjik dy vjeçar duke përpiluar edhe tekstin e saj; Përpilon dhe kujdeset shumë për hartimin e "Fjalorit të gjuhës shqipe", i pari fjalor i atij lloji që u botua prej Institutit të Shkencave dhe doli nga shtypi në vitin 1954. Ai është autor i disa fjalorëve dygjuhësh si edhe i Gramatikës së Shqipes I dhe II si dhe u mor me përpilimin e disa antologjive të folklorit. Shkolla jonë u pajis me një tog librash si , "Libri i gjuhës e gramatikës ", " Njohuritë e para të sintaksës shqipe", "Sintaksa Shqip" pjesa e dytë, të cilat ndihmuan klasat e ulta të shkollave shqiptare. Këto libra u përdorën për më tepër se 20 vite.(Autori)

e normativ, të mbështetura në një njohje më të mirë të gjuhës shqipe ishin "Fillime të pedagogjisë", 1933 dhe "Pjesa e dytë : Didaktikë e edukatë " e vitit 1926. Së bashku me K.Cipon hartoi e botoi (1930) për shkollat e mesme "Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme" dhe së bashku me një tjetër, një abetare. Përshtati veprën "Histori e letërsisë greke" për kursin e lartë të liceut (1941), me interes të veçantë për gjuhën e qartë, ndërtimet shqipe e terminologjinë letrare të krijuar e të përdorur.

Fushë tjetër themelore e veprimtarisë së Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit ka qenë *gjuhësia*. Ai bëri një punë të vijueshme sistematike, të shumanëshme, të frytshme për lëvrimin e studimin e gjuhës shqipe, frymëzuar nga idetë patriotike të Rilindjes dhe mbështetur në një formim filologjik të mirë. Kjo veprimtari u karakterizua nga një vështrim i qartë e objektiv i çështjeve, nga një njohje e mirë e natyrës dhe e veçorive të gjuhës shqipe, e visarit leksikor dhe e strukturës gramatikore të saj, nga vlerësimi i lartë i gjuhës së gjallë të popullit, nga lufta këmbëngulëse për një shqipe sa më të pasur e të pastër dhe të paqortueshme, nga përpjekja e vijueshme për ngritjen gjithnjë e më lart të gjuhës letrare⁴.

Aleksandër Xhuvani që ndër të parët gjuhëtarë shqiptarë të përgatitur mirë, që bënë studime të rregullta filologjike, si nxënës i gjuhëtarit të njohur grek Haxhidhaqis. I pajisur me një logjikë të fortë e një mendje të qartë, ai i hyri studimit të gjuhës shqipe i armatosur mirë dhe, që në kohën kur ishte ende student i Universitetit (1905-1906), ai nis të shkruajë nëpër revistat dhe gazetat shqipe të kohës.

Studenti, e më pas mësuesi i ri i shqipes në kolegjin arbëresh të Shën Mitrit të Koronës merr pjesë në diskutimet e hapura në shtypin kombëtar për probleme të përgjithshme të rëndësishme si gjuha letrare kombëtare e rrugët e formimit të saj, rreth pastërtisë së gjuhës dhe pasurimi i leksikut të saj, për alfabetin e shqipes e njësimi i tij. Çështje të drejtshkrimit e të kodifikimit të gjuhës së shkruar, boton studime e përkthime. Vëmendje të veçantë meritojnë dy nga artikujt e tij të botuar në revistën "Albania" të Brukselit (1905) dhe në gazetën arbëreshe "La nazione Albanese" (1906), ku studiuesi i ri jep mendime për gjuhën letrare kombëtare me objektivitet, me një vështrim të qartë, në frymë kombëtare e parimore, larg çdo anësie dialektore e krahinore.

Ai shprehet kundër formimit të gjuhës letrare nëpërmjet përzierjes së dialekteve, mbron tezën se gjuha letrare e përgjithshme formohet në bazë të një dialekti, duke u shuar dialektet e tjera, se janë përcaktuese arsyt historike dhe jo arsyt e thjeshta gjuhësore. Për një sërë arsyesh ai shqiptohet për të marrë dialektin jugor si themel të gjuhës letrare e jo të folmen e Elbasanit, duke u pasuruar ajo me fjalë e elemente të të folmeve të tjera .

⁴ - Vepra studimore e Aleksandër Xhuvanit për studimin e gjuhës shqipe është e lidhur ngushtë me mendimin përparimtar të periudhës së Rilindjes Shqiptare, pasi ata i jepnin një rëndësi të veçantë gjuhës së kombit si veçorit e tij dhe dallimi kryesor i kombit, si hallkë e fortë e bashkimit kombëtar (Autori)



Prof. Dr. Aleksandër Xhuvani luftoi e punoi që gjuha e shkruar të zhvillohej në bazë të gjuhës popullore, pa u shkëputur prej kësaj gurre, duke u përtërirë e duke u gjallëruar vazhdimisht prej saj, sipas veçorive e ligjeve të gjuhës sonë, pa u ndrydhur e shtrembëruar nga veprimi e ndikimi i gjuhëve të tjera, po ashtu që të ruhet pastërtia e saj, që ajo të pasurohet e stabilizohet gjithnjë e më shumë.

Prof.A.Xhuvani e çmon lart *përkthimin*, e vë atë në një radhë me krijimin a hartimin e një veprë origjinale, vë në dukje vështirësitë e një përkthimi të mirë, e godet punën pa përgjegjësi të përkthyesve të asaj kohe, jep këshilla për punën e kujdesur që duhet bërë.

Është frazeologjia e saj krejt shqipe, lidhja e mendimeve, e fjalëve, e frazave, që duhet të kenë frymën dhe ngjyrën e shqipes. Në përkthim e sipër duhet të mendohesh shqip duke i dhënë fjalisë e periudhës një ngjyrim e petk me nuancë shqiptare dhe duke njohur kulturën, frazeologjinë si dhe fjalët dhe shprehjet popullore në luftë me përkthimin fjalë për fjalë.

A.Xhuvani luftoi kundër shtrembërimit të trajtave e të kuptimit të fjalëve, ndryshimeve arbitrare që i bëhen gjuhës së gjallë të folur të popullit. *"Morfologjinë... - shkruan ai më 1944 - nuk mund ta krijojmë ne, kjo asht e krijueme dhe e formueme në gjuhë tue u gatue e ndryshue qysh prej kohëvet të lashta në gojë të popullit. Puna jonë është me i marrë trajtat si i gjejmë në gojë të njerëzisë, me i studjue këto e me gjetë evolucionin, në të cilin ka shkue fjala dhe ka arrimë në trajtën e fundit. Ne s'kemi të drejtë me i ndryshue trajtat e fjalëvet mba s mirakandes ose haemendjes sonë, sikurse s'kemi të drejtë më krijue fjalë, të reja a me përkthye të tilla prej gjuhëvet të huaja, pa marrë para syh rregullat e gjuhës dhe natyrën e saj".⁵ I udhëhequr nga një kuptim i drejtë i gjuhës, lëvruesi i shquar shprehet kundra vënies në qarkullim të trajtave e kuptimeve arkaike të tejkaluara kundra përpjekjeve për ta mbajtur të pandryshueshëm këtë mjet të komunikimit midis njerëzve të një kolektivi, kundra një ligjërimi artificial."E shkrueme ose e folun, - vëren ai, - asnji gjuhë nuk asht e ngulun; ... edhe gjuha merr një evolucion të papremë.⁶*

Prof.A. Xhuvani u ka kushuar vëmendje të vijueshme çështjeve të drejtshkrimit dhe i ka dhënë një kontribut të rëndësishëm kodifikimit dhe stabilizimit të tij . Artikulli i parë i tij (1905) trajtoi një çështje shumë problemore të gjuhës letrare; shkrimin e ë-së. shkroi shënime e vërejtje në shtyp në kohë të ndryshme, punoi për përcaktimin e rregullave drejtshkrimore në komisionet letrare të viteve 1917-1918 e 1920-21', luftoi për një drejtshkrim fonetik e të thjeshtë, sa më të përgjithshëm e të njëjtë, të ngulët e të kristalizuuar.

Më tutje ai thekson se duhet shtuar se etimologjia atje ku e kanë marrë mbrapa autorët, e ka pështjelluar ortografinë kaq fort , sa që janë shfaqur ankime dhe më pas, prej linguistëve për këtë pështjellim ka pasur vështirësi, sepse e ngulur një herë, ortografia

⁵ Xhuvani, A., Mahir Domi, "Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar", Tiranë, 1980, f. XIX

⁶ Domi, M., "Aleksandër Xhuvani lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe", "Studime për nder të A. Xhuvanit", Tiranë, 1986, f. 47

është punë tepër e vështirë që të dalë pastaj gjuha prej labirinthit të saj. ... Sot bota përpigën gjithnjë, që ta afrojnë ortografinë me fonetikë duke mos marrë parasysh etimologjinë.

Për të gjitha këto arsye që u parashtruan më lart, besoj se do të bindet gjithkush se në punë të ortografisë duhet të shkojmë mbas *fonetikës* dhe jo mbas etimologjisë. Stabilizimit e ngulitjes së drejtshkrimit e në përgjithësi kodifikimit të gjuhës letrare u bëri shërbim të madh edhe me gjuhën e kujdesur të veprave që botoi e sidomos me librat mësimorë të gjuhës që hartoi, libra që lozën rol mjaft edhe në përgjithësimin e këtyre rezultateve. Veçanërisht e rëndësishme qe puna që zhvilloi Prof. Dr.Aleksandër Xhuvani pas Çirimit për kodifikimin e njësimit më të madh të drejtshkrimit të gjuhës sonë . Ai drejtoi dhe mori pjesë aktive në hartimin e udhëzuesve drejtshkrimorë që u hartuan njëri pas tjetrit në intervale kohe të shkurtra (1949, 1951, 1953, 1956) duke qenë redaktori i dy të parëve dhe redaktori përgjegjës i të gjithave.

Këta udhëzues i zgjeruan gjithnjë e më shumë dy variantet e gjuhës letrare që ekzistonin dhe përgatitën gradualisht terrenin për të kaluar më pas në një drejtshkrim të vetëm, plotësisht të kodifikuar, që saktësoi njësimit përfundimtar të gjuhës sonë letrare. Prof.Dr. Aleksandër Xhuvani ka luftuar vijimisht e me këmbëngulje për pastërtinë e gjuhës shqipe, për zhvillimin e saj e për pasurimin e saj në bazë të veçorive dhe të ligjeve që e karakterizojnë.

Ky ka qenë filli që ka përshkuar gjithë veprimtarinë e tij prej lëvruesi të shqipes gjatë gjithë jetës. *"Të mos e prishim gjuhën tonë me fjalë të huaja të panevojshme"* - kjo ka qenë porosia e vazhdueshme e tij. Për këtë shkruan më 1910, më 1921, më 1944 e më vonë, pa ia ndarë vëmendjen as në vitet e fundit të jetës së tij. Në vitet 1949-1956 ai zhvilloi në këtë fushë një punë të vijueshme. Ndiqte me kujdes praktikën gjuhësore, merrte shënime nga revista, gazeta, libra, ndërhynte me gojë e me shkrim për të mënjeluar të metat e vëna re, duke tërhequr vërejtjen për rrezikun që paraqiste pakujdesia në këtë çështje kaq të rëndësishme. Botoi një sërë artikujsh si "Letrari i Ri" dhe "Nëndori", të cilët i përmbloodhi e i shkriu më pas (1960) në veprën "Për pastërtinë e gjuhës shqipe". Ansje tjetër nuk bëri një punë aq ngulmuese për këto probleme si ai . Këtu Prof.Aleksandër Xhuvani eci në gjurmët e rilindasve të mëdhenj, si Kristoforidhit, Sami e Naim Frashërit etj., vijoi më tej punën e tyre, po me një njohje më të gjerë e më të sigurt të gjuhës shqipe , me një përgatitje më të rregullt filologjike , me një vështrim më të matur, më të drejtë të çështjeve, pa rënë në teprimet e tyre, të kushtëzuara edhe nga rrethanat historike të kohës .

Ai nuk qe për në purizëm të skajshëm , që do ta varfëronte gjuhën , do të ndalte zhvillimin e saj . Në artikullin " Për thjeshtësinë e gjuhës " ("Shkolla e re", 1928, 5-7) ai shkruan: *"Por as idetë e puristëve, as ato të kundërshtarëve të tyre nuk kanë zotëruar sot kryekëput; duke e kufizuar gjuhën në një cak të ngushtë të shkrimtarëve klasikë veç që e bën gjuhën të hollshme e pedantore, është edhe një punë kundër natyrës së gjuhës e cila, sikurse çdo gjë tjetër, hyn në ligjet e*



evolucionit e nuk mundet të thellohet pas dëshirës të një pale; për të pranuar në tjetër anë çdo gjë të huaj në gjuhë e me njohun përdorimin vetëm si mjeshtër e udhëheqës (usus norma loquendi , thotë Horaci) është një punë që zvenit e prish këtë.”. Dhe më tutje : “ për t’u ruajtën thjeshtësia e pastërtija e gjuhës shqipe duhet që një pjesë e madhe e barbarizmevet të nxirren jashtë prej gjuhës duke u përdorur në vend të këtyre fjalëve konstruktive krejt shqipe”.⁷

Thamë se një pjesë e madhe e këtyre dhe jo të gjithë barbarizmat , duke u përgjithësuar në gojën e popullit, sot janë bërë si një pjesë e pandarë e gjuhës më të vështirë dhe mbase nuk do mund të përktheheshin me fjalë të tjera shqipe... Sikurse në të gjitha gjuhët e botës kështu janë futur edhe në shqipe fjalët e huaja me shumicë, të cilat, mbasi janë përdorur prej popullit që nga kohët e vjetra, janë bërë, si thamë, brumi e prona e gjuhës e nuk mundet të shporren aq kollaj. Nga gjuha duhet të flaken barbarizmat e zeza që, për zëvendësimin e madh të gjuhës, janë duke u futur për ditë në të.”

“Pastërtia e gjuhës” titullohet një shkrim i tij i vitit 1950, ku theksohet edhe një herë me forcë nevoja, detyra për ta shkruar gjuhën e vet drejt e pastër. “Asht koha , - shkruhet aty – që në këtë Shqipni të lirë, ku kemi tregue një përparim të madh në çdo sektor të jetës sonë... Të kallëzohet një kujdes të veçantë edhe për gjuhën tonë tue e folë e tue e shkruet pa gabime dhe, sa asht e mundun, pa elementë të huaja. Thash “ sa asht e mundun”, se asnjë gjuhë nuk mund t’i reshtet influencës së një gjuhe të huej e të jetë e pastër dhe e dliër nga çdo gja e huej...”. Dhe tërheq vëmendjen për përdorimin e fjalorëve të huaja pa nevojë si edhe të ndritimeve e lidhjeve sintaksore të ndikuara nga gjuhët e huaja, po ashtu edhe për gabimet gramatikore.⁸

Prof. Aleksandër Xhuvani, bën pjesë në inteligjencën e studiuesve të shquar që u kushtohen tërësisht idealeve të mëdha të kombit e që për këtë arsye në jetën dhe me veprimtarinë e tyre, gjithçka merr një vlerë shoqërore të përgjithshme me rëndësi kombëtare. Prandaj, edhe letërkëmbimet, që të shumtën e herës kanë një karakter personal, në këtë rast ngrihet mbi marrëdhëniet e zakonshme e intime dhe bëhet edhe ai shprehës i interesave më të gjera e burim i rëndësishëm për të plotësuar aspekte të ndryshme të veprimtarisë e të personalitetit të Aleksandër Xhuvanit.⁹ A. Xhuvani, si një figurë e shquar, me një veprimtari të gjerë e të shumanshme, që u njoh e pati jehonë jo vetëm në botën kulturore e shkencore brenda vendit, por edhe në rrethet shkencore albanologjike të huaja, kishte letërkëmbim me shumë personalitete përparimtare shoqërore e shkencore të kohës; gjuhëtarë

⁷ Po aty, f.32

⁸ - Po aty, f. 35

⁹ Prof. Aleksandër Xhuvani shtjelloi një veprimtari të gjatë e të sukseshme në fusha të ndryshme të kulturës e të shkencave tona shoqërore që nga periudha e Rilindjes e cila i dha një profil shkencor dhe një vështrim të qartë çështjeve për një njohje të gjuhës shqipe në gjerësi dhe në thellësi të strukturës gramatikore si edhe visarin leksikor të saj, duke tentuar për një gjuhë sa më të pasur dhe sa më letrare. (Autori)

, shkrimtarë, publicistë e të tjerë me të cilët u këshillua, diskutoi dhe shkëmbeu mendimet për problemet e ndryshme që e shqetësonin atë!

Në këtë letërkëmbim aq të pasur një vend të veçantë e me rëndësi, sidomos në fushën e gjuhësisë, zë letërkëmbimi me albanologun e njohur e dashamirës të gjuhës shqipe Prof. Norbert Jokli me të cilin pati korenspondencë të rregullt që nga viti 1921 deri në vitin 1940. Aleksandër Xhuvani nuk u lidh rastësisht me këtë figurë të shquar të albanologjisë të shekullit tonë, që pati një veprimtari intensive e pothuajse mbizotëruese në këtë fushë në vitet ‘20 e ‘30 të shekullit të kaluar. Ai ishte figura qendrore e gjuhësisë shqiptare në atë kohë. Ajo që i lidhi ngushtë Xhuvanin me Joklin ishte dëshira, përpjekja dhe shqetësimi i përhershëm i Aleksandër Xhuvanit për ta çuar përpara studimin e gjuhës shqipe edhe në fushën e historisë së saj me të cilën në atë kohë merreshin kryesisht studiues të huaj.

Tek Norbert Jokli ai shikonte një studiues të zellshëm e objektiv të gjuhës e të studimeve shqiptare, një autoritet shumë të saktë në këtë fushë tek i cili mund të mbështej me kompetencë në fjalën e tij për problemet e historisë së gjuhës shqipe duke u vënë fre mendimeve jo shkencore e shpesh tendencave antishqiptare që qarkullonin në literaturat e kohës për ta shmangur nga njerëz jo mirëdashës të gjuhës shqipe e të popullit shqiptar.

Jo më kot ai dërgonte këtë kërkesë N.Joklit në datën 10.8.1922 :

“ Ju lutem shumë të më përgjigjeni për çashtjet qi Ju shkruet në letrët gjermanishte, pse dhe njëherë e përgjithmonë t’ua mbyllë gojën atyneve me mendimin tând t’autoritetshëm . Letrën në gjermanisht qi po ju dërgoj bashkë me përgjigjen qi do të më dërgoni kam për t’i shpallun të dyja në të përkohshmen pedagogjike qi do të dalë për së afërmi. Pastaj do t’u vërsulem unë, qi kështu të mos guxojnë mâ të shruet dokrra.”¹⁰

... Në një letër i shkruan N. Joklit (30.IX.1936) ndër të tjera ;

“ Unë vetëm kam pasë mbledhë fjalë e fraza të ndryshme, të qëmtueshme gjithandej dhe prej njerëzish të ndryshëm”!¹¹

Karakteristike ishte pjesëmarrja e Aleksandër Xhuvanit në biseda e takime të ndryshme ku e shikoje me një shkresë të vogël apo skeda ku shënonte plot vëmendje fjalë, kuptime fjalësh, togje e frazeologjizma, që sillnin diçka të re saktësuese rreth gjuhës shqipe. Pra, ne mund të themi se Xhuvani ka dhënë ndihmesën e vet në punime leksikologjike, në dialektologji, studime gjuhësore si edhe ndihmesa më e madhe e tij ishte të ndërtimi i fjalorit të përgjithshëm të shqipes.

Ajo që, ne, studiuesit e veprës së Prof. Xhuvanit ndihemi keq se, Xhuvani nuk pati kohë t’u bënte materialeve të qëmtuara apo të vjela përpunimin e duhur, të bënte ato ç’ka ai mendonte dhe njëjthe në këto sfera gjuhësore duke i verifikuar, duke i plotësuar,

¹⁰ -Letrat e Norbert Jokli drejtuar A. Xhuvanit, u përgatitën dhe u botuan me një hyrje nga Prof. Mahir Domi, "Xhuvani, A., "Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar", Tiranë, 1980, f. XXXI, prag. 1

¹¹ Po aty, f.XXXI,prag. 3



duke i krahasuar dhe duke bërë ballafaqimet e nevojshme që të shfaqte prezencën e vet si studiues i gjuhës shqipe duke theksuar se artikujt dhe punimet që karakterizoheshin nga një njohje shumë e gjerë dhe e saktë e pasurisë së gjuhës shqipe, nga qartësia dhe objektiviteti i vështrimeve, japin materiale e vëzhgime të pasura e të sigurt, kriteret e drejta, mendime e të dhëna të pasura që dëshmonin për koncepte të drejta dhe dijeni të gjera të visarit leksikor të gjuhës sonë duke ia shtruar veprën një kritike të imtë e të shumanëshme.

Si përfundim mund të themi se gjuhësia është fusha së cilës A.Xhuvani i kushtoi gjithë jetën e tij duke iu futur studimeve gjuhësore që në rininë e tij. Çështjet e gjuhës i ka parë vazhdimisht në lidhje të ngushtë me strukturat gjuhësore si dhe me nevojat e shkollës dhe të kulturës kombëtare. Ndiheza e tij ka qenë në të gjitha fushat e gjuhësisë shqiptare, si: në leksikologji, e leksikografi, në gramatikë e në histori të gjuhës, në fushën e formimit të fjalëve dhe të kulturës së gjuhës duke dhënë ndihmesën e Tij të rëndësishme në studimet teorike gjuhësore, ashtu edhe në zgjidhjet praktike me rëndësi për gjuhën letrare shqipe, për arsimin dhe për leksikografinë. Artikujt, punimet, monografitë e tekstet e tij janë me vlerë të madhe shkencore. Me një kujdes të veçantë, ndihmoi për formimin e punonjësve të rinj të shkencës si dhe për organizimin e veprimtarisë shkencore mbi baza të shëndosha. Studimet për gjuhën shqipe dhe dëshirën për ta lëvruar atë. Ai e shfaqti që në shkrimet e para, në diskutimet shkencore në shtypin e kohës për çështjet të ndryshme të gjuhës letrare, ku dallohet për formimin e shëndoshë shkencor, për mendimin e pjekur dhe egon e të studiuarit me themel të kësaj gjuhe. Gjatë gjithë kohës që i përket fillimeve të shekullit XX, ai diti të japë ndihmesën e vet si brenda ashtu edhe jashtë vendit duke e parë edhe gjatë kohës ku vendi i tij jetonte periudhen e Luftës së Dytë Botërore. Duhet që të theksoj se ndihmesë të madhe Aleksandër Xhuvani dha për gjuhën shqipe në një periudhë disavjeçare kur ishte drejtor i Shkollës Normale të Elbasanit, ku punoj vetë për kërkime gjuhësore, por edhe përgatiti nga rradhët e nxënësve, gjurmues të zellshëm të pasurisë gjuhësore shqiptare.

Çështja e një gjuhe letrare kombëtare të përpunuar e të ngritur që ka përshkruar gjithë zhvillimin gjuhësor dhe patriotik, sidomos që nga rilindja e këtij zë një vend qëndror në veprimtarinë e Xhuvanit si lëvrues e studiues i gjuhës shqipe. Ai u ngrit me një vështrim të gjerë mbi pikëpamjet e shtrembëra, të ngushta, krahinore e penguese në kuptimin e vlerësimit e gjuhës së përbashkët kombëtare sidomos të formës së saj më të përpunuar, gjuhës letrare.

Ai mbrojti tezën e drejtë se gjuha jonë letrare e

përbashkët do të formohej jo nga një përzjerje mekanike e dialekteve dhe të folmeve të ndryshme. Aleksandër Xhuvani ishte për të vënë në themel një dialekt të caktuar, duke e plotësuar atë dialekt bazë me pasurinë e dialekteve të tjera. Në caktimin e dialektit që duhej marrë për themel ai nisej nga arsyet historike e nga shkalla e përdorimit të tij në të gjitha llojet e veprimtarisë letrare dhe jo thjesht gjuhësore. Gjuha e punimeve dhe veprave të tij dallohet për pastërtinë e fjalorit, për pasurinë me fjalë e shprehje të bukura të popullit, për ndërtimin e qartë e të rrjedhshëm të frazës.

Duke pasur në konsideratë visarin leksikor e frazeologjik të shqipes, fjalët dhe shprehjet e veriut dhe të jugut, të malësisë e të fushës, të fshatit e të qytetit, si dhe të gjuhës së folur e të shkruar, debuton si njohësi më i mirë i këtij visari të pashtershëm të kësaj gjuhe të lashtë dhe të vjetër në familjen indoevropiane.

Si anëtar i Komësisë Letrare të Shkodrës, Aleksandër Xhuvani, luajti një rol të rëndësishëm në mendimet që ai dha rreth afrimit të gegërishtes letrare me toskërishten letrare ku merrnin pjesë figura të shquara të arsimit e të kulturës shqiptare, si: Luigj Gurakuqi, Sotir Peçi, Ndre Mjeda, Hil Mosi, Mati Logoreci, Gjergj Pekmezi etj.

Xhuvani, në përcaktimin e normës letrare udhëhoq nga kriteret objektive. Ai ka kundërshtuar rreptë kurdoherë delitancizmin dhe subjektivizmin në zgjidhjen e problemeve të gjuhës letrare duke mos u pajtuar kurrë me ata që kujtonin se normën letrare mund t'a krijojnë gramatikanët sipas dëshirës së tyre. Ai theksonte vazhdimisht se, puna e gjuhëtarëve është që t'i marrin trajtat ashtu si i gjejnë në gojë të popullit dhe t'i studiojnë ato e jo t'i ndryshojnë sipas mijëra kandës ose hamendjes së tyre që do të thotë se tashmë gjuha shqipe kishte studiues potent dhe që mund t'a përfaqësonin atë jo vetëm brenda Shqipërisë, por edhe në qarqet e ndryshme ballkanike dhe evropiane. Si pedagog e teoricient ai i kushtoi vëmendje të madhe problemeve e përmbajtjes së shkollës dhe karakterit të saj kombëtare duke vënë theksin se, fëmija, duhet të mësohet që të doj vetveten por edhe kombin. Shkolla dhe sistemi arsimor duhet të ndërtojnë mbi bazën e psikologjisë dhe të individualitetit të popullit sipas traditave të tij më të mira.

Referime bibliografike

"Aleksandër Xhuvani", Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Trashëgimi kulturor i popullit shqiptar, Tiranë, 1980

"Aleksandër Xhuvani i lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe", Mahir Domi, Studime për nder të A.



Xhuvanit", Tiranë, 1986.

"*Studime Filologjike*", Prof. M. Domi, "Prof. Dr. N. Jokli(1877-1942), 1972, 4 ; Tiranë, 1972

"*La politica dell'Italia in Albania*", Cappelli , Rocca San Casciano, 1965, f. 183

Jokl Nachllas, *Autograf* 279/ 114

"*Dosje të Arkivit të Albanologjisë* ", L/9 nr.181;Arka 4/ kutia 3

"*Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe*", bot.1980, Tiranë.

"*Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*".Shaban

Demiraj, Tiran, 1986

" *Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit XIX*", Sh. Demiraj, BUSHT,SSHSH, nr. 4, 1958,dhe nr. 1 , 159,49-53

" *Buletin për shkencat shoqërore*",1954,nr.2 dhe ribotim në vëllimin " *Studime gjuhësore*",

" *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipet*". Ribotuar në vëllimin " *Studime gjuhësore*".

A.Xhuvani, Tiranë , 1956.